

KOMUNA E FERIZAJIT



STRATEGJIA
e
ZHVILLIMIT
EKONOMIK LOKAL
2005 - 2007

Mars 2005

**PROJEKTI: Zhvillimi i Ndërmarrjeve Lokale nëpërmjet
Aksionit dhe Aleançës (DELTA II)**

**Projekt për zhvillimin ekonomik, i bashkëfinancuar nga
Instituti për Shoqëri të Hapur, komunat pjesëmarrëse dhe
“Friedrich Ebert Stiftung”**



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Vërejtje

Kjo strategji është hartuar nga Ekipi Komunal, me këshilla dhe udhëzime të Grupit të Bankës Botërore, Institutit për Shoqëri të Hapur dhe “Riinvest”-it. Grupi i Bankës Botërore, Instituti për Shoqëri të Hapur dhe “Riinvest”-i nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e kësaj strategjie, sidoqoftë ato përgëzojnë Ekipin Komunal për cilësinë e punës.

PËRMBAJTJA

	Faqe
HYRJE	1
I. ORGANIZIMI I PËRPPJEKJEVE	3
II. VLERËSIMI I EKONOMISË LOKALE	7
III. ANALIZA E KONKURRUESHMËRISË (SWOT)	17
IV. VIZIONI	19
V. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT	21
VI. NGA VIZIONI DREJT PROJEKTEVE	23
VII. AMËZA E PROJEKTEVE NË RAPORT ME SYNIMET	27
VIII. IMPLEMENTIMI I PROJEKTEVE TË ZHEL-it	29
PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE	33
Aneksi 1. Grupet punuese	65
Aneksi 2. Grupi i palëve me interes	66

HYRJE

“Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e Komunës së Ferizajit 2005-2007” ka rezultuar nga Projekti DELTA II. Komuna e Ferizajit është zgjedhur në këtë projekt së bashku me katër komuna të tjera të Kosovës¹.

DELTA II është bashkëfinancuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI) në Budapest, përderisa vetë komunat pjesëmarrëse në projekt dhe “Friedrich Ebert Stiftung” (FES) kanë kontribuar financiarisht në një masë më të vogël. Banka Botërore nga Uashingtoni mbështeti projektin duke i ofruar asistencë teknike. Projekti është implementuar nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore “Riinvest”, në Prishtinë. Synimi i projektit ishte “aftësimi i komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillim të NVM (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme)”. Përveç synimit, DELTA II ka patur edhe disa objektiva, si forcimi i kapaciteteve të administratës komunale për të hartuar dhe implementuar Strategjitë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL), mbështetja e komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e NVM-ve dhe forcimi i partneritetit ndërmjet qeverisë komunale, komunitetit biznesor dhe shoqërisë civile.

Strategjia përmban Vizionin, Synimet, Objektivat, Programet dhe Projektet, të cilat janë të lidhura dhe të harmonizuara me njëra-tjetrën. Strategjia do të konsiderohet si bazë për Qeverinë Komunale të Ferizajit për periudhën e ardhshme trevjeçare 2005-2007.

Si është hartuar Strategjia? Në fillim të procesit për hartimin e strategjisë janë formuar Ekipi Komunal për ZHEL dhe Grupi Punues, si dhe është themeluar Forumi i Palëve të Interesuara. Ekipi për ZHEL dhe Grupi Punues kanë marrë mbështetje politike nga udhëheqësit komunalë. Gjatë hartimit të strategjisë janë

¹ Pesë komunat pjesëmarrëse në projektin DELTA II janë: Gjilani, Peja, Ferizaj, Drenasi (ish-Gllogoci) dhe Lipjani.

organizuar katër punëtori (workshops), në të cilat Ekipi për ZHEL i komunës së Ferizajit ka marrë pjesë aktive. Punëtoritë janë ndarë në orë teorike dhe praktike dhe i tërë procesi është ndihmuar nga Ekipi Menaxhues i projektit DELTA II nga “Riinvest”-i, por gjithashtu edhe nga ekspertët vendorë nga “Riinvest”-i dhe konsulentët ndërkombëtarë. Pas çdo punëtorie janë përgatitur planveprimet, të cilat kanë shërbyer si udhërrëfyes për Ekipin Komunal të ZHEL-it, për të zhvilluar aktivitetet hartuese strategjike. Ekipi Komunal, në bashkëpunim me Grupin Punues dhe i mbështetur nga palët e interesuara komunale, ka punuar në grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave dhe definimin e Vizionit, Synimeve, Objektivave, Programeve dhe Projekteve.

Gjithashtu, Ekipi Komunal për ZHEL mori pjesë në vizitën studiuëse në Slloveni nga 26 shtatori deri më 2 tetor 2004, në të cilën u informua lidhur me përvojat sllovene në fushën e ZHEL-it, administratën lokale, hartimin e strategjive zhvillimore, zonat biznesore, inkubatorët biznesorë në Slloveni, etj.

I. ORGANIZIMI I PËRPPJEKJEVE

Komuna e Ferizajt planifikimin strategjik e ka filluar me përkrahjen e kryetarit, kryeshefit ekzekutiv dhe drejtorëve të drejtorive, të cilët kanë formuar grupin punues për ZHEL, i cili përbehet nga 5 anëtarë, të cilët kanë administruar, kanë koordinuar dhe kanë udhëhequr gjithë procesin.

Anëtarët e Ekipit Komunal të Ferizajt për ZHEL janë:


1. Dukagjin Etemi - Drejtor Komunal për Ekonomi dhe Financa - udhëheqës i Ekipit
2. Lulzim Shabani - nëpunës në Drejtorinë për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim dhe përfaqësues i biznesit - NSH "UNIVERSE" - anëtar
3. Arsim Sahiti - Drejtor Komunal për Bujqësi dhe Zhvillim Rural -anëtar
4. Bashkim Jashari - Drejtor Komunal për Urbanizëm - anëtar dhe
5. Gafurr Ilazi - Drejtor Komunal për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim – anëtar.

Drejtues dhe mbështetës politik i grupit punues për ZHEL është kryeshefi ekzekutiv Sahit Krasniqi. Prej datës 19 deri më 27 prill, Ekipi Komunal për ZhEL ka identifikuar përfaqësuesit e institucioneve publike, bizneseve, industrive, organizatave civile, organizatave private profesionale, grupeve të ekspertëve dhe ka formuar grupet e gjera punuese dhe palët me interes.

Më datën 12. 05. 2004 është mbajtur takimi i parë me palët e interesuara, ku ata janë informuar për rëndësinë e projektit dhe rolin e tyre në këtë projekt. Në këtë takim është formuar komiteti drejtues, i udhëhequr nga Hamdi Qerimi, përfaqësues i Bankës së Re të Kosovës.

Ekipi për ZHEL mbajti katër takime me palët me interes, zakonisht në fund të çdo plani të veprimeve, me qëllim që të vlerësohet progresi i strategjisë. Rendi i ditës së çdo mbledhjeje dhe materiali është shpërndarë çdoherë disa ditë përpara takimit. Takimet dhe disa aktivitete të tjera të Ekipit të ZHEL-it kanë qenë të përcjellura nga përfaqësuesit e mediave lokale.

Organizimi i Komunës së Ferizajt



Pas formimit të grupeve punuese, Ekipi për ZHEL vazhdoi me grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave për lëvizjet demografike, punësimin, arsimin, NVM-të, bizneset dhe strukturën e tyre, investimet, infrastrukturën, etj., si dhe ka vazhduar me analizën e aftësisë konkurruese. Në vazhdim ekipi komunal në bashkëpunim me akterët tjerë komunalë, kanë bërë edhe definimin e vizionit, synimeve dhe objektivave për periudhën e ardhshme trevjeçare. Në kuadër të aktiviteteve të projektit, e me qëllim të shfrytëzimit të përparësive dhe shanseve të komunës si dhe eliminimit të dobësive, gjegjësisht mënjanimit të rreziqeve, ekipi komunal ka bërë edhe identifikimin e programeve dhe projekteve, të cilat do të shërbejnë si bazë për qeverinë komunale në arritjen e synimeve strategjike. Në fund të projektit është bërë kompletimi i strategjisë komunale për zhvillim ekonomik lokal dhe publikimi i saj. Si pjesë e pashmangshme e tërë këtij procesi ka qenë edhe Kuvendi Komunal, i cili ka qenë vazhdimisht i njoftuar dhe i kyçur me rrjedhat e hartimit të strategjisë, dhe i cili në fund të procesit ka bërë aprovimin formal të strategjisë.

Hierarkia organizative për hartimin e Strategjisë së ZHEL-it

Skema e paraqitur më poshtë tregon se ekipi komunal ka patur mbështetje politike për hartimin e strategjisë nga kryetari i Kuvendit Komunal të Ferizajt, Adem Salihaj, dhe nga Kryeshefi Ekzekutiv, Sahit Krasniqi, i cili, përveç mbështetjes politike, ekipit komunal i ka ofruar edhe përkrahje administrative dhe profesionale nëpërmjet drejtorive qeveritare komunale.

Buxheti Komunal

Tabela 1. Struktura e buxhetit komunal për vitet fiskale 2004 dhe 2005

	Buxheti 2004			Buxheti 2005		
	Buxheti 2004	Granti qeveritar	Të hyrat vetanake	Buxheti	Granti	Të hyrat vetanake
Programi	4,687,425	2,258,504	2,428,921	2,428,921	4,032,367	1,789,021
Administrata	4,486,048	4,451,048	35,000	35,000	4,537,471	4,429,471
Arsimi	1,053,817	815,240	238,577	238,577	1,076,488	876,488
Shëndetësia	52,917	52,917	0	0	53,943	53,943
ZLK	138,895	138,985			138,048	138,048
Brigada e Zjarrfikësve	10,417,102	7,714,604	2,702,498	2,702,498	9,838,317	7,349,971
Gjithsej	4,687,425	2,258,504	2,428,921	2,428,921	4,032,367	1,789,021

Në tabelën e mësipërme janë pasqyruar shënimet me të cilat ka disponuar Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Buxheti komunal sigurohet prej dy burimeve: grantet nga qeveria qendrore dhe të ardhurat vetanake: Buxheti i komunës për vitin 2004 ishte 10.417.102 € nga qeveria qendrore janë siguruar 7.714.604 € ndërsa nga të ardhurat e komunës janë siguruar 2.702.498 €

Krahasuar të hyrat vetanake të vitit 2004 dhe 2005, në vitin 2005 ka një rënie të këtyre të hyrave. Arsyeja e kësaj rënieje është se në vitin 2004 planifikimi i të hyrave vetanake për komunat është bërë nga ana e Ministrisë për Ekonomi e Financa, ku disa prej të hyrave janë planifikuar në nivel shumë të lartë, kështu që për komunën inkasimi i këtyre të hyrave ka qenë i pamundur. Shembull për këtë për komunën e Ferizajt mund të shërbejë planifikimi i të hyrave për tatimin në pronë për vitin 2004. Të hyrat nga tatimi në pronë janë planifikuar në shumë prej 714.300,00 € ndërsa në bazë të Qarkores mbi hartimin e buxhetit të hyrat nga tatimi në pronë duhej të planifikoheshin afërsisht rreth 500.000,00 € Kur kësaj i shtohet e dhëna se për vitin 2004, bazuar në rregulloren 2003/29 (neni 8), kemi një zvogëlim të vlerës së objekteve të banimit për 10.000 € kjo ka ndikuar në mënyrë automatike në zvogëlimin e tatimit në pronë për rreth 160.000,00 € gjë që tregon se planifikimi i të hyrave vetanake për komunën nuk ka qenë real.

Krahasuar me të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2004, që janë 2.702.498,00 € dhe të hyrat vetanake të inkasuara që kapin shumën 1.692.456,07 € apo 62,62% të inkasuara në krahasim me të planifikuarat, jemi të detyruar që planifikimin e të hyrave vetanake për vitin 2005 ta bëjmë në nivel më të ulët.

Edhe pse të hyrat vetanake të komunave përdoren ekskluzivisht për projekte kapitale, që është në interesin e drejtpërdrejt të qytetarëve, kjo do të thotë se rëndësia e inkasimit të hyrave vetanake është shumë e madhe për komunën. Në këtë drejtim, synim kryesor i komunës do të mbetet mbledhja e tatimit në pronë, si një nga pozicionet më të rëndësishme të të hyrave buxhetore komunale.

II. VLERËSIMI I EKONOMISË LOKALE

Historiku

Qyteti i Ferizajt, krahasuar me rrethinën e tij, është vendbanim relativisht i ri, një ndër qendrat me të reja të Kosovës, që nënkupton se edhe ekonomia e këtij qyteti është zhvilluar në vitet e vonshme.

Njëri ndër faktorët më të rëndësishëm nga e kaluara historike për formimin e qytetit të Ferizajt dhe të zhvillimit ekonomik të tij është padyshim ndërtimi i vijës hekurudhore (1874) dhe stacionit hekurudhor, linjë kjo shumë e rëndësishme për transportimin e udhëtarëve dhe të mallrave, që njëkohësisht ndikoi shumë në ndryshimin e fizionomisë së vendbanimit, i cili sot është shndërruar në qytet.

Zanafilla e ekonomisë së qytetit tonë fillon me disa veprimtari ekonomike, kryesisht zejtare dhe tregtare. Kështu për shembull, në vitin 1900 Ferizaji kishte 400 shtëpi, nga të cilat 200 ishin dyqane. Përveç Fabrikës së Tjegullave, të gjitha ndërmarrjet tjera që ekzistojnë në Ferizaj janë themeluar pas Luftës së Dytë Botërore. Ekonomia e Ferizajt, deri në aplikimin e masave të dhunshme (vitet 1989-1990), ishte mjaft e zhvilluar, sidomos industria metalike, industria e përpunimit të drurit, industria ushqimore dhe ndërtimtaria. Përveç këtyre, në Ferizaj janë të zhvilluara edhe degët e tjera të ekonomisë si: tregtia, komunikacioni (transporti), pylltaria, bujqësia etj.

Rrënimi i autonomisë së Kosovës, i përcjellë me aplikimin e masave të dhunshme dhe me largimin masiv të punëtorëve shqiptarë nga vendet e tyre të punës, e sidomos periudha e luftës, lanë pas vetes pasoja të mëdha në ekonominë e Ferizajt. Pas luftës janë bërë përpjekje për konsolidimin e këtyre ndërmarrjeve drejt rivitalizimit dhe aktivizimit të kapaciteteve, mirëpo rezultatet nuk janë inkurajuese.

Pozita gjeografike

Ferizaji si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike.

Shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 344.71 km.² Kufizohet me shtatë komuna të tjera. Distanca e Ferizajt nga Prishtina është 36 km, kurse nga Shkupi 48 km.

Veçanti e komunës së Ferizajt është bifurkacioni i lumit Nerodime, fenomen ky i rrallë hidrografik në botë, ujërat e të cilit ndahen dhe derdhen në dy drejtime, njëri në Detin Egje dhe tjetri në Detin e Zi. Ky fenomen është unikat në Evropë.

Relievin e komunës së Ferizajt e karakterizojnë tri tërësi natyrore: vargmalet e Sharrit në përendim dhe veriperëndim, Rrafshi i Kosovës dhe disa zona kodrinoro-malore në lindje.



Pasuritë natyrore

Komuna e Ferizajt është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Kompleksi i vargmaleve të Sharrit është i pasur me florë dhe faunë të zhvilluar, si dhe me relief karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojllojshmërinë e shkëmbinjve dhe mineraleve të pastuduara sa duhet. Ndërkaq, zonat e rrafshëta janë të mbuluara nga depozitimet e neogjenit dhe nëpër këto shtresa hasim në minerale të dobishme siç janë: rëra e kuarcit afër Mirosalës, rëra argjilore te fusha e Aeroportit Bujqësor, mineralet e plumb-zinkut te fshati Mirash, uji mineral afër fshatit Gaçkë dhe shtresa të linjtit që ndodhen në gjithë

hapësirën e depozitimeve neogjene, si dhe nafta e supozuar në thellësi 1600 m. Në lindje të komunës së Ferizajt supozohen rezervat e argjilës. Afër fshatit Zllatar ekziston masa e leuciteve (mineral fosfori) si material për prodhimin e plehrave artificiale.




Miniera sipërfaqësore e eksploatimit të rërës kuarcore në Mirosalë

Popullsia²

Sipas vlerësimeve, komuna e Ferizajt duhet të ketë rreth 140.000 banorë. Dendësia e popullsisë është 406 banorë në një km². Norma mesatare vjetore e shtimit (nataliteti) të popullsisë është ndërmjet 26 dhe 30%. Mortaliteti sillet në shkallën ndërmjet 6 dhe 7‰.

Komuna e Ferizajt ka 44 fshatra, të cilat janë të organizuara në 11 bashkësi lokale.

Në fshatra jeton përafërsisht gjysma e popullatës së kësaj komune.



Popullsia e Ferizajt, 1989 – 2010 (parashikim)

Si bazë për nxjerrjen e këtyre të dhënave është marrë regjistrimi i popullsisë së vitit 1981, ndërsa përlogaritja e të dhënave demografike është bërë duke shfrytëzuar koeficientin mesatar të natalitetit (në promila) nga regjistrimet e mëparshme.

Arsimi

Në komunën e Ferizajt sistemi arsimor zhvillohet sipas niveleve të treguara në tabelën në vijim:

Tabela 2. Numri i nxënësve sipas niveleve shkollore

Viti shkollor 2003/2004	Numri
Çerdhe: 9 muaj - 5 vjet	187 fëmijë
Arsimi parafillor	1658 fëmijë
Arsimi fillor, klasa I-IX	20701 nxënës
Arsimi i mesëm i lartë, X, III, IV	5066 nxënës
Shkolla e lartë teknike	78 studentë

Ndër problemet kryesore në fushën e arsimit janë sidomos mungesa e lokalit të mjaftueshëm shkollor, në qytet shkollat fillore punojnë në 3 dhe 4 ndërrime, mungesa e kabineteve, e mjeteve mësimore, mësimi praktik kabinetik-laboratorik, mungesa e bibliotekave shkollore, sallave të edukatës fizike, terreneve sportive, mungesa e punëtorive të shkollat e mesme profesionale etj.

Për ta përmirësuar gjendjen e kuadrit, Kuvendi Komunal dhe Drejtoria e Arsimit kanë ndarë 100 bursa, sidomos për studentët e lëndëve deficitare, por në të ardhmen kërkohet që të rritet numri i bursistëve, në bazë të nevojave të komunës për kuadër përkatës.

Për kualifikimin, rikualifikimin dhe specializimin e qytetarëve të komunës së Ferizajt janë organizuar disa trajnime nga Qendra për Aftësi Profesionale, Qendra Didaktike dhe Universiteti i Punëtorëve.

Papunësia

Sipas shënimeve nga Qendra Rajonale për Punësim, në maj të vitit 2004, në komunën e Ferizajt janë evidencuar 15.669 punëkërkuar, prej të cilëve 6.286 apo 40.11% janë femra. Mirëpo, kjo pasqyrë nuk paraqet gjendjen reale për normën e papunësisë, sepse qytetarët, duke pasur parasysh mundësitë e pakta të punësimit nëpërmjet këtyre qendrave, nuk janë lajmëruar në këtë qendër.

Tabela 3. Punëkërkuar sipas kualifikimit

Punëkërkuar sipas kualifikimit	Numri
Të pakualifikuar	7,931
Gjysëm të kualifikuar	748
Të kualifikuar	2,406
Me shkollë të mesme	4,233
Me shkollë të lartë	191
Me fakultet	160
Total	15,669

Burimi: Qendra Regjionale e Punësimit, Ferizaj, Maj 2004

Tabela 4. Punëkërkuessit sipas moshës

Punëkërkuessit sipas moshës	Numri
16-24 vjeç	3,390
25-39 vjeç	8,079
40-54 vjeç	3,715
55 +	485
Total	15,669

Burimi: Qendra Regjionale e Punësimit, Ferizaj, Maj 2004

Infrastruktura fizike

Në përgjithësi infrastruktura në qytet është në nivel jo të kënaqshëm dhe nuk i plotëson nevojat për banorët e qytetit, duke filluar nga sasia jo e mjaftueshme e ujit të pijes, mungesa e kanalizimit në 45% të territorit të qytetit, si dhe rrjeti i vjetëruar i telekomunikacionit. Edhe përkundër investimeve të shumta që janë pas luftës, akoma shumë mbetet për të bërë, e në veçanti sa i përket infrastrukturës rrugore, energjisë, furnizimit me ujë, kanalizimit dhe telekomunikimeve.

Ekziston nevoja për plane të reja urbanisitke pasi që atyre ekzistuese u ka skaduar afati dhe për më tepër popullata po rritet çdo ditë, dhe si rrjedhojë plani i ri duhet t'u përshtatet kërkesave të reja për ndërtesa banimi dhe objekte biznesi.

Ekonomia

Rrethina biznesore - Autoritetet në komunën e Ferizajt kanë ndërmarrë aktivitete të shumta për zhvillimin e mirëfilltë të bizneseve: duke filluar nga lehtësimi i qasjes në lokacion, dhënia e pëlqimit për plotësimin e kushteve ambientale, dhënia e lejes së punës, caktimi i tatimeve dhe ngarkesave, dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e tokës bujqësore, caktimi i qirasë për objektet komunale, përmirësimi i infrastrukturës e të ngjashme.

Kohë më parë Asambleja Komunale ka liruar nga taksa komunale bizneset prodhuese dhe ka shpallur dy zona industriale për biznese prodhuese.

Kuvendi Komunal ka miratuar edhe disa vendime dhe rregullore në funksion të zhvillimit më efikas të bizneseve, si:

- Rregullorja për kushtet minimale teknike të objekteve dhe hapësirave afariste për kryerjen e veprimtarive hoteliere,
- Rregullorja mbi orarin e punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Ferizajt,

- Rregullorja mbi inspeksionin e tregut,
- Vendimi mbi licencimin e subjekteve afariste,
- Rregullorja mbi tatimin në pronë,
- Rregullorja mbi mbikëqyrjen higjieniko-shëndetësore të artikujve ushqimorë dhe të gjërave në përdorim të përhershëm.

Drejtoritë në Kuvendin Komunal të cilat janë të inkuadruara në zhvillimin e bizneseve private janë: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Drejtoria e Inspektoratit, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim, Drejtoria për Urbanizëm, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme. Anketimi me disa nga bizneset të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në komunën e Ferizajt, i kryer nga “Riinvest”-i dhe AER-i, ka treguar se administrata e pushtetit lokal në Ferizaj duhet të krijojë kanale më të mira të komunikimit me sektorin privat dhe OJQ-të. Disa nga menaxherët shprehen se, edhe pse ekziston një nivel i caktuar i bashkëpunimit ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit të biznesit, mungon bashkëpunimi i koordinuar, si dhe akoma mund të përmirësohet.

Në komunën e Ferizajt aktivitetin e tyre e zhvillojnë edhe 7 banka, por gjatë anketimit është vërejtur se klientët nuk janë të kënaqur me kushtet e kreditimit.

Në përmirësimin e rrethinës biznese në komunën tonë ka ndikuar edhe kompania amerikane “Brown&Root”, në të cilën, sipas disa shënimeve nga interneti, kishte 4.700 të punësuar.

Në komunën e Ferizajt ekzistojnë edhe rrjete mbështetëse për zhvillimin e bizneseve: Zyra Rajonale për Zhvillim të Bizneseve, OEK – rajonale dhe Shoqata e Biznesit. Veprojnë edhe shoqata të tjera profesionale si ajo e zejtarëve, blegtorëve, ekonomistëve, juristëve etj.

Ndërmarrjet shoqërore - Deri në aplikimin e masave të dhunshme (vitet 1989-1990), ekonomia e Ferizajt ishte mjaft e zhvilluar, sidomos industria metalike, industria e përpunimit të drurit, industria ushqimore dhe ndërtimtaria. Përveç kësaj, në Ferizaj janë të zhvilluara edhe degët tjera të ekonomisë si: tregtia, komunikacioni (transporti), pylltaria dhe bujqësia etj.

Aplikimi i masave të dhunshme, largimi masiv i punëtorëve shqiptarë nga ndërmarrjet shoqërore dhe periudha e luftës, lanë pas vetes pasoja të mëdha në ekonominë e Ferizajt. Pas luftës janë bërë përpjekje për konsolidimin e këtyre ndërmarrjeve drejt rivitalizimit dhe aktivizimit të kapaciteteve, mirëpo rezultatet nuk janë inkurajuese.

Në komunën e Ferizajt aktivitetin ekonomik e zhvillojnë 25 ndërmarrje shoqërore dhe publike, sipas kësaj strukture që shihet në tabelë. Megjithatë, niveli i aktivitetit të ndërmarrjeve shoqërore është shumë i dobët.

Tabela 5. Ndërmarrjet shoqërore sipas numrit të subjekteve dhe numrit të punëtorëve

Përshkrimi	Numri i subjekteve	Numri i punëtorëve
Ndërmarrjet bujqësore	4	152
Pylltaria	1	62
Ndërmarrjet tregtare	7	353
Industria përpunuese	8	2443
Shërbimet komunale publike	1	58
Ndërtimtaria	2	208
Riparimet dhe mirëmbajtja	1	235
Hotelet dhe restorantet	2	46
Ndërmarrjet transportuese	2	329
Ndër. fin. (sigurimet)	1	9
Totali	29	1696

Në komunën e Ferizajt janë komercializuar dy ndërmarrje.

Fabrika e Vajit, e cila është komercializuar në shtator të vitit 2001, ka 160 punëtorë që punojnë me orar të plotë, 25 marrin ndihma sociale dhe 20 gëzojnë përkrahje. Të ardhurat mesatare janë 325 €

Ndërmarrje tjetër e komercializuar është edhe fabrika për prodhimin dhe përpunimin e fryteve ekzotike “Minex”, e cila ka 210 punëtorë.

Ndërmarrja e vetme e privatizuar në komunën e Ferizajt është “Plantacioni i pemëve”, e cila ka 67 punëtorë, kurse në proces të privatizimit është edhe kombinati i drurit “Tefik Çanga”.

Sektori privat - Në bazë të shënimeve që ofron Drejtoria për Ekonomi dhe Financa e Komunës së Ferizajt, numri i bizneseve të regjistruara arrin në 4220 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, në të cilat janë të punësuar 7120 punëtorë. Struktura sipas veprimtarive të këtyre NVM-ve duket si vijon: prodhuese 14%, shërbyese 40%, tregtare 46%. Kompanitë më të mëdha janë të shënuara në aneks.

Bujqësia - Komuna e Ferizajt posedon 19.010 ha tokë bujqësore dhe 12.810 ha pyje: gjithsej 31.820 ha. Nga sipërfaqet me kultura bujqësore pjesëmarrje më të madhe ka gruri (5000 ha), misri (4200 ha), livadhet dhe kullosat (6550 ha). Janë tri ndërmarrje bujqësore të cilat zhvillojnë veprimtari, por të kufizuara, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, mekanizmit bujqësor të vjetëruar si dhe pamundësisë së sigurimit të inputeve. Autputi i fermerëve nga sektori privat i plotëson vetëm nevojat për konsum familjar, rrjedhimisht nuk mbetet asgjë për

treg. Komuna e Ferizajt posedon këtë fond blegtoral: 6790 krerë lopë, 240 krerë viça, 3.815 krerë dele dhe 68.950 pula.

Kultura, mediat dhe trashëgimia kulturore

Ferizaj ka disa objekte dhe institucione kulturore: **Shtëpinë e Kulturës “Hivzi Sylejmani”**, godinë e ngritur më 1924 (një nga objektet më të lashta në qytet), **Bibliotekën Publike të Qytetit**, godinë e ngritur më 1928, dhe shtatë biblioteka nëpër fshatra, **Bibliotekën “Anton Çetta”**, **Teatrin Profesional “Adriana Abdullahu”**, **Galerinë e Arteve**, **Kinemanë e Qytetit**, **Arkivin Historik të Qytetit dhe Muzeun e Qytetit**.

Në komunën e Ferizajt zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore dhe manifestime tradicionale: **Muaji i Kulturës**, **Festivali i Teatrove të Kosovës**, **Festivali “Kosovarja këndon”**, **Festivali “Fëmijët e gëzuar”**, **Karnevali “Sofra ferizajase”**, **Festivali i Recitatorëve të Kosovës**.

Aktivitet të vazhdueshëm zhvillojnë edhe këto shoqëri, teatro e klube:

ansambli i këngëve dhe i valleve “Kastriotët”, klubi letrar “De Rada”, shtëpia botuese “Zgjimi”, shoqata e artistëve figurativë “Zef Kolombi”, klubi letrar i fëmijëve dhe të rinjve “Nol Berisha”, teatri “Vëllezërit Frashëri”, teatri i të rinjve “PO PO”, teatri “Therandus”, teatri “Shkëndijat e para”, AVI “Trix”, AVI “7me7”, AVI “Rok Gjini”, SHKA “Harmonia”, SHKA “7 Shtatori”, SHKA “Marigona”, shtatë shoqëri kulturore që janë të organizuara nëpër fshatra.

Mediat

Në komunën e Ferizajt aktivitetin e tyre e zhvillojnë këto medime:

“RTV Festina”, “TV Liria”, “Radio Tema”, “Radio Ferizaj”, “Radio Fortuna”, “Informatori komunal”.

Monumentet historike

Ferizaji është qytet i ri, por rrethina e tij ka qenë e banuar që nga kohët e lashta. Në bazë të disa hulumtimeve që janë bërë në Varosh, Komogllavë, Jezerc, Nerodime e në vende të tjera, dhe nga arkeologë e etnografë, është thënë se Ferizaj ka një potencial të madh të objekteve me vlerë nga lashtësia. Ndër këto duhet veçuar Kishën Dardane, mbeturinat e së cilës gjenden në malet midis fshatrave Komogllavë, Sojevë e Fshat i Vjetër; ujësjellësi i kohës ilire-romake në fshatin Komogllavë, që furnizon me ujë të pijes edhe sot disa familje, tumat (varrezat) ilire në fshatin Varosh, mbetjet e qytetit të vjetër në Jezerc, gërmadha të ndryshme të kohëve të ndryshme në Nerodime etj. Me rëndësi të veçantë është puna hulumtuese dhe mbledhja e materialeve nga antika e nga trashëgimia kulturore e kësaj treve.

Organizatat joqeveritare dhe institucionet ndërkombëtare

Në komunën e Ferizajt ushtrojnë aktivitete disa OJQ vendore dhe ndërkombëtare. Disa nga OJQ-të vendore më aktive janë: rrjeti i gruas “Ajo”, ”Afrodita”, ”Gratë Ardhmëria e Shoqërisë-Rrahovicë”, ”Hendikos- Ferizaj”, ”Hendifer-Ferizaj”, ”Zëri i Popullit-Dubravë”, ”Yllka-Sazli”, ”Edona-Dubravë”, ”Shoqata e të rinjve”. Spektri i OJQ-ve është i larmishëm dhe veprojnë në fusha të ndryshe, si në sferën e të drejtave të njeriut, dhuna ndaj grave dhe të rinjve, gratë në politikë etj.

III. ANALIZA KONKURRUESE (SWOT)

<i>Përparësitë</i>	<i>Dobësitë</i>
<ul style="list-style-type: none"> Û Pozita e volitshme gjeografike. Distanca rrugore e Ferizajt nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina, është 36 km, kurse nga Shkupi 48 km. Û Toka e plleshme bujqësore Û Rrjedha e lumit Nerodimja Û Sipërfaqet pyjore të mjaftueshme Û Resurset njerëzore (mosha e re -kualifikimet adekuatë) Û Traditat industriale Û Ekzistenca e një ambienti të volitshëm për biznese (çaktimi i dy zonave industriale për biznese prodhuese dhe lirimi i tyre nga tarifat komunale) Û Niveli i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) Û Niveli i punësimit në organizata 	<ul style="list-style-type: none"> Û Infrastruktura fizike jo e kënaqshme Û Mungesa e planit urbanistik dhe hapësinor Û Niveli i pamjaftueshëm i investimeve Û Niveli jo i kënaqshëm i partneritetit ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit të biznesit Û Shndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore pa kriterë dhe degradimi i sipërfaqeve pyjore Û Komunikimi i dobët me diasporën Û Sistemi arsimor jokompatibil me nevojat e biznesit Û Struktura e pavolitshme e bizneseve - numri i vogël i bizneseve prodhuese
<i>Mundësitë</i>	<i>Rreziqet</i>
<ul style="list-style-type: none"> Û Shfrytëzimi i kapitalit nga diaspora Û Aplikimi i përvojave të avancuara nga vendet në tranzicion dhe vendet e zhvilluara Û Privatizimi Û Potencialet për zhvillimin e agrobiznesit Û Zhvillimi i turizmit Û Trajnimet, aftësimet, rikualifikimet profesionale Û Disponueshmëria e gjerë e mundësive për financim 	<ul style="list-style-type: none"> Û Statusi i padefinuar i Kosovës Û Mungesa e infrastrukturës ligjore për funksionimin efikas të ekonomisë së tregut Û Konkurrenca jolojale në treg Û Politika jo e drejtë ekonomike ndaj agrobiznesit (prodhimtaria e farës së grurit, sojës, lulediellit, bimëve industriale)

IV. VIZIONI

Ferizaj është qytet me vlera të shumta, ku sistemi arsimor do të plotësojë nevojat e biznesit, qytet me potenciale rinore dhe intelektuale dhe qendër rajonale e përparimit dhe e zhvillimit. NVMtë do të jenë sektori mëi frytshëm i zhvillimit ekonomik. Secila ditë do të sjellë rritje dinamike të punësimit. Qyteti e rrethina do të kenë ambient të rregulluar urbanistik. Zonat industriale do të mundësojnë ecjen drejt industrializimit bashkëkohor dhe lidhjes me rrjedhat e përbotshme ekonomike. Bujqësia do të ofrojë mundësi për prodhim të ushqimit cilësor. Do të shumëfishohen investimet për objekte rekreacioni, për turizëm e për ambient të shëndoshë. Qeveria lokale do të jetë në shërbim të bizneseve dhe e vendosur për të tërhequr e për të siguruar të gjithë investitorët. Ferizaj është qytet me ardhmëri.

V. SYNNIMET DHE OBJEKTIVAT

S₁: Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për rritjen e biznesit

S₁O₁: Deri në vitin 2007 të aprovohet plani urbanistik dhe të fillojë implementimi i tij

S₁O₂: Më 2007, 90% e bizneseve të anketuara të shprehet e kënaqur me gjendjen e infrastrukturës.

S₂: Qeveria lokale të bëhet më e përgjegjshme ndaj nevojave të biznesit

S₂O₁: Ngritja e nivelit profesional dhe efektivitetit të administratës komunale në shërbim të bizneseve, ashtu që të shkurtohet koha për procedurat administrative

S₂O₂: Deri në vitin 2007, të sigurojë nivel të kënaqshëm të partneritetit ndërmjet administratës komunale dhe të biznesit, në mënyrë që anketimet të tregojnë se bashkëpunimi është i kënaqshëm në mbi 70 % të bizneseve.

S₃: Ambient i përmirësuar i investimeve

S₃O₁: Të përmirësohet struktura e bizneseve, ashtu që deri në vitin 2007 mbi 25% e tyre të jenë prodhuese.

S₃O₂: Deri në vitin 2007 të dyfishohet vëllimi i investimeve.

S₄: Të inkurajohet prodhimtaria bujqësore

S₄O₁: Rehabilitimi i rrugëve ku shtrihen sipërfaqe bujqësore.

S₄O₂: Të sigurohet rritja e prodhimitarisë bujqësore 30%.

S₅: Të përmirësohet dhe të ruhet ambienti jetësor.

S₅O₁: Të arrihet që në vitin 2007, qytetarëve t'u ofrohet një ambient i shëndoshë jetese.

S₅O₂: Të ngritet dukshëm niveli i trajtimit të mbeturinave

S₆: Të përmirësohet sistemi arsimor, që të jetë kompatibil me kërkesat e ekonomisë së tregut.

S₆O₁: Gjatë periudhës 2005-2007, arsimi i mesëm të pajiset me shkathtësi praktike.

S₆O₂: Të stimulohen kuadrot deficitare për arsim superior. Deri në vitin akademik 2006/2007 të rritet numri i bursistëve për kuadra deficitare deri në 50%

VI. NGA VIZIONI DREJT PROJEKTEVE

<i>Vizioni</i>	<i>Synimet</i>	<i>Objektivat</i>	<i>Programet</i>	<i>Projektet</i>	
<p>Ferizaj është qytet me vlera të shumta, ku sistemi arsimor do të plotësojë nevojat e biznesit, qytet me potenciale rinore dhe intelektuale dhe qendër rajonale e përpimit dhe e zhvillimit. NVMtë do të jenë sektori më frytshëm i zhvillimit ekonomik. Secila ditë do të sjellë rritje dinamike të punësimit. Qyteti e rrethina do të kenë ambient të rregulluar urbanistik. Zonat industriale do të mundësojnë ecjen drejt industrializimit bashkëkohor dhe lidhjes me rrjedhat e përbotshme ekonomike. Bujqësia do të ofrojë mundësi për prodhim të ushqimit cilësor. Do të shumëfishohen investimet për objekte rekreacioni, për turizëm e për ambient të shëndoshë. Qeveria lokale do të jetë në shërbim të bizneseve dhe e vendosur për të tërhequr e për të siguruar të gjithë investitorët. Ferizaj është qytet me ardhmëri.</p>	<p>S₁: Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për rritjen e biznesit</p>	<p>S₁O₁: Deri në vitin 2007 të aprovohet plani hapësinor urbanistik dhe të fillojë implementimi i tij</p>	<p>S₁O₁Pg₁: Programi i hartimit (planifikimit, disenjimit) të planit hapësinor urbanistik</p>	<p>S₁O₁Pg₁p₁: Plani urbanistik i qytetit</p>	
		<p>S₁O₂: Më 2007, 90% e bizneseve të anketuara të shprehet e kënaqur me gjendjen e infrastrukturës.</p>	<p>S₁O₁Pg₂: Programi për aprovimin e rregullativës për disenjimin e planit hapësinor</p>	<p>S₁O₁Pg₂p₂: Trajnimi i stafit për planifikimin urban</p>	
			<p>S₁O₂Pg₁: Programi për investime në infrastrukturë fizike</p>	<p>S₁O₂Pg₁p₁: Instalimi i kanalizimit në lagjen III dhe IV të qytetit</p>	
	<p>S₁O₂Pg₂: Programi për lehtësimin e transportit të mallrave</p>		<p>S₁O₂Pg₁p₂: Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike</p>		
	<p>S₂: Qeveria lokale të bëhet më e përgjegjshme ndaj nevojave të biznesit</p>	<p>S₂O₁: Ngritja e nivelit profesional dhe efektivitetit të administratës komunale në shërbim të bizneseve, ashtu që të shkurtohet koha për procedurat administrative</p>	<p>S₁O₂Pg₂p₁: Asfaltimi i rrugëve të qytetit</p>	<p>S₂O₁Pg₁: Programi për trajnimin të stafit komunal</p>	<p>S₂O₁Pg₁p₁: Trajnimi i stafit komunal në tekn. informative</p>
			<p>S₁O₂Pg₂p₂: Asfaltimi i rrugëve lokale</p>	<p>S₂O₁Pg₁p₂: Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e projekteve</p>	
<p>S₁O₂Pg₂p₃: Asfaltimi i rrugëve në vendbanimet rurale</p>			<p>S₂O₁Pg₁p₃: Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e buxhetit</p>		

	S ₃ : Ambient i përmirësuar i investimeve	<p>S₂O₂: Deri në vitin 2007, të sigurojë nivel të kënaqshëm të partneritetit ndërmjet administratës komunale dhe të biznesit, në mënyrë që anketimet të tregojnë se bashkëpunimi është i kënaqshëm në mbi 70 % të bizneseve</p>	<p>S₂O₂Pg₁: Programi i ndërlidhjes ndërmjet qeverisë lokale dhe bizneseve</p>	<p>S₂O₂Pg₁p₁: Themelimi i Zyrës për shërbime të shpejta (ndërlidhëse) bizneseve</p> <p>S₂O₂Pg₁p₂: Buletini informativ i biznesit</p> <p>S₂O₂Pg₁p₃: Anketimi i komunitetit të biznesit</p> <p>S₂O₂Pg₁p₄: Krijimi i uebsajtit lokal të komunës</p> <p>S₂O₂Pg₁p₅: Trajnimi i asociacioneve të biznesit</p>
		<p>S₃O₁: Të përmirësohet struktura e bizneseve, ashtu që deri në vitin 2007 mbi 25% e tyre të jenë prodhuese</p>	<p>S₃O₁Pg₁: Programi për nxitjen e bizneseve të reja prodhuese</p>	<p>S₃O₁Pg₁p₁: Zona industriale</p> <p>S₃O₁Pg₁p₂: Mbështetja e bizneseve prodhuese</p> <p>S₃O₁Pg₁p₃: Themelimi i fondit për ZHEL</p>
	S ₄ : Të inkurajohet prodhimtaria bujqësore	<p>S₃O₂: Deri në vitin 2007 të dyfishohet vëllimi i investimeve</p>	<p>S₃O₂Pg₁: Programi për promovimin e investimeve</p>	<p>S₃O₂Pg₁p₁: Formimi i klubit të ambasadorëve</p> <p>S₃O₂Pg₁p₂: Pjesëmarrja në projekte të donatorëve</p> <p>S₃O₂Pg₁p₃: Inkubatori i biznesit</p> <p>S₃O₂Pg₁p₅: Binjakëzimi i komunave</p>
		<p>S₄O₁: Rehabilitimi i rrugëve ku shtrihen sipërfaqe bujqësore</p>	<p>S₄O₁Pg₁: Përmirësimi i infrastrukturës fizike për nxitje të prodhimtarisë bujqësore</p>	<p>S₄O₁Pg₁p₁: Hapja e shtratit të lumit Sazlija</p> <p>S₄O₁Pg₁p₂: Rregullimi i rrugëve ku shtrihen sipërfaqe bujqësore</p>
		<p>S₄O₂: Të sigurohet rritja e prodhimtarisë bujqësore 30%.</p>	<p>S₄O₂Pg₁: Programi i mbjelljes së bimëve industriale</p>	<p>S₄O₂Pg₁p₁: Trajnimi dhe stimulimi i prodhuesve sipas metodave të reja bujqësorë</p>

	S₅ : Të përmirësohet dhe të ruhet ambienti jetësor.	S₅O₁ : Të arrihet që në vitin 2007, qytetarëve t'u ofrohet një ambient i shëndoshë jetese.	S₅O₁Pg₁ : Programet e rritjes së investimeve në infrastrukturë fizike	S₅O₁Pg₁p₁ : Mbulimi me sistem të kanalizimit i tërë territorit të qytetit S₅O₁Pg₁p₂ : Hulumtimi i resurseve natyrore (ujit) S₅O₁Pg₁p₃ : Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit për gjashtë fshatra
		S₅O₂ Të ngritet dukshëm niveli i trajtimit të mbeturinave	S₅O₂Pg₁ : Programi për menaxhimin e mbeturinave (ngritja e deponisë)	S₅O₂Pg₁p₁ : Ndërtimi i deponisë së mbeturinave
			S₅O₂Pg₂ : Programi për mbrojtjen e ambientit	S₅O₂Pg₂p₁ : Ndërtimi i parqeve (zonave të gjelbëra) në qytet S₅O₂Pg₂p₂ : Investimet në rregullimin e bifurkacionit të lumit Nerodimja
	S₆ : Të përmirësohet sistemi arsimor, që të jetë kompatibil me kërkesat e ekonomisë së tregut.	S₆O₁ : Arsimi i mesëm të orientohet nga kërkesat e tregut dhe të punësimit	S₆O₁Pg₁ : Programi për aftësimin praktik të nxënësve	S₆O₁Pg₁p₁ : Organizimi i punëtorive (workshopeve) nëpër shkolla
			S₆O₂ : Të stimulohen kuadrot deficitare për arsim superior. Deri në vitin akademik 2006/2007 të rritet numri i bursistëve për kuadro deficitare deri në 50%	S₆O₂Pg₁ : Përkrahja financiare e studentëve universitarë

VII. AMËZA E PROJEKTEVE NË RAPORT ME SYNIMET

SYNIMET		Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për rritjen e biznesit	Qeveria lokale të bëhet më e përgjegjshme ndaj nevojave të biznesit	Tërheqja e projekteve të reja investive të brendshme nga sektori privat, publik dhe i huaj, si dhe krijimi i ambientit të volitshëm për thithje të investimeve	Të stimulojë investimet në bujqësi	Të përmirësohet dhe të ruhet ambienti jetësor	Të përmirësohet sistemi arsimor, që të jetë kompatibil me kërkesat e ekonomisë së tregut
		S1	S2	S3	S4	S5	S6
PROJEKTET							
Infrastrukturë e lehtë							
1	Plani Gjeneral Urbanistik	X		X		X	
2	Trajnimi i grupit për planifikim urban	X					
3	Themelimi i Zyrës për shërbime të shpejta dhe Zyrës për përkrahjen e bizneseve		X	X			
4	Zona industriale		X	X			
5	Themelimi i fondit të ZHEL-it		X	X			
6	Krijimi i uebsajtit lokal	X	X	X			
7	Trajnimi i stafit në teknologjinë informative dhe në lëmitë tjera	X	X	X			
8	Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e projekteve	X	X	X			
9	Trajnimi i stafit kom. Për menaxhimin e buxhetit	X	X	X			
10	Aftësimi i asocioneve të biznesit	X	X	X			
11	Mbështetja e bizneseve prodhuese		X	X			
12	Anketimi i komunitetit të biznesit		X				
13	Buletini informativ i biznesit		X				
14	Binjakëzimi i komunave		X	X			
15	Formimi i Klubit të Ambasadorëve		X	X			

16	Inkubatori i biznesit		X	X			
17	Pjesëmarrja në projekte të donatorëve	X		X			
18	Ndarja e bursave për kuadro	X					X
19	Organizimi i punëtorive punuese nëpër shkolla		X				X
20	Ndërtimi i parqeve (zonave) të gjelbëra në qytet					X	
21	Trajnimi dhe stimulimi i prodhuesve bujqësorë					X	
Infrastrukturë e rëndë							
22	Kanalizimi në lagjen III dhe IV	X					
23	Mbulimi me sistem të kanalizimit i tërë territorit të qytetit						
24	Asfaltimi i rrugëve të qytetit	X					
25	Asfaltimi i rrugëve lokale	X					
26	Investimet në rregullimin e bifurkacionit të lumit Nerodimja			X			
27	Asfaltimi i rrugëve në venbanimet rurale	X					
28	Ndërtimi i sistemit të ujësjellesit në gjashtë fshatra		X				
29	Ndërtimi i deponisë së mbeturinave					X	
30	Hapja e shtratit të lumit Sazlija					X	
31	Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike	X					
32	Rregullimi i rrugëve për sipërfaqet bujqësore					X	
33	Hulumtimi i resurseve natyrore (ujit)	X					

Struktura e projekteve është si vijon:

- a) Infrastrukturë institucionale dhe ngritje e kapaciteteve janë: 21 projekte
- b) Infrastrukturë fizike janë: 12 projekte

Vlera e përgjithshme e investimeve në projektet e identifikuar është
5 632 000 €

Burimet e financimit planifikohen nga:

- 1) Burimet komunale,..... 77 %
- 2) Donatorët 18 %
- 3) Komuniteti 5 %
- 4) Komuniteti i biznesit 13 %

Pasqyra detale e projekteve është si në tabelën VIII.

VIII. PLANI IMPLEMENTUES I PROJEKETEVE TË ZHEL-it

Nr.	Titulli i projektit	Burimet e financimit (%)	Organizatrat implementuese dhe partnerët	Kohëzgjatja	Viti i fillimit	Grupet e synuara/përfituesit	Përputhen me qëllimet
1	Plani Gjeneral Urbanistik	350.000	Komuna 80%, Donatorët 20%	Komuna+ Donatorët	2 vite	2005	Komuna+Komuniteti +Biznesi+OJQ
2	Trajnimi i grupit për planifikim urban	10.000	Komuna 80%, Donatorët 20%	Komuna+ Donatorët	6 muaj	2005	Komuna+Komuniteti +Biznesi
3	Themelimi i Zyrës për shërbime të shpejta dhe Zyrës për përkrahjen e bizneseve	20.000	Komuna 85%, Kom. i biznesit 15%	Komuna+ Kom. i biznesit	6 muaj	2005	Komuna +Biznesi
4	Themelimi i fondit të ZHEL-it	180.000	Komuna 80%, Donatorët 20%	Komuna+ Donatorët	2 vite	2005	Komuna+Komuniteti +Biznesi
5	Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e projektve	10.000	Komuna	Komuna	6 muaj	2005	Komuna+Komuniteti +Biznesi
6	Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e buxhetit	8.000	Komuna	Komuna	6 muaj	2005	Komuna+Komuniteti +Biznesi
7	Trajnimi i stafit në teknologjinë informative dhe në lëmitë tjera	20.000	Komuna 80%, Donatorët 20%	Komuna+ Donatorët	6 muaj	Ka filluar	Komuniteti +Biznesi
8	Krijimi i uebsajtit lokal	20.000	Komuna 90%, Kom. i biznesit 10%	Komuna+ Kom. i biznesit	3 muaj	2005	Komuna+Biznesi
9	Anketimi i komunitetit të biznesit	3.000	Komuna 90%, Kom. i biznesit 10%	Komuna+ Kom. i biznesit	3 muaj	2005	Komuna+Biznesi
10	Aftësimi i asociacioneve të biznesit	10.000	Komuna 90%, Kom. i biznesit 10%	Komuna+ Kom. i biznesit	3 muaj	2005	Komuna+Biznesi
11	Buletini informativ i biznesit	8.000	Komuna 90%, Biznesi 10%	Komuna+ Kom. i biznesit	I vazhdueshëm	2005	Komuniteti +Biznesi
12	Binjakëzimi i komunave	30.000	Komuna 50%, Donatorët 50%	Komuna+ Donatorët +	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuna+Komuniteti +Biznesi

13	Formimi i Klubit të Ambasadorëve	25.000	Komuna 70%, Donatorët 20%, Biznesi 10%	Komuna+ Donatorët+ Biznesi	I Vazhdueshëm	2005	Komuna+Biznesi
14	Inkubatori i biznesit	350.000	Komuna 90%, Kom. i biznesit 10%	Komuna+ Kom. i biznesit	3 muaj	2005	Komuna+Biznesi
15	Pjesëmarrja në projekte të donatorëve	300.000	Komuna	Komuna+ Kom. i biznesit	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuna+Komuniteti+ Biznesi +OJQ
16	Ndarja e bursave për kuadro	400.000	Komuna 60%, Donatorët 40%	Komuna+ Donatorët	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuniteti +Biznesi
17	Organizimi i punëtorive punuese nëpër shkolla	80.000	Komuna	Komuna	6 muaj	2005	Komuna +Biznesi
18	Investimet ne rregullimin e bifurkacionit të lumit Nerodimja	28.000	Komuna	Komuna	2 muaj	2005	Komuna
19	Hapja e shtratit të lumit Sazlija	50.000	Komuna	Komuna	2 muaj	2005	Komuna+Fermerët
20	Ndërtimi i parqeve (zonave) të gjelbëra në qytet	180.000	Komuna 70%, Donatorët 30%	Komuna+ Donatorët	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuna+Komuniteti
21	Trajnimi dhe stimulimi i prodhuesve bujqësorë	50.000	Komuna 80%, Donatorët 20%	Komuna+ Donatorët	I vazhdueshëm	2005	Fermerët
22	Kanalizimi në lagjen III dhe IV	350.000	Komuna 75%, Komuniteti 25%	Komuna+ Komuniteti	2 vite	Ka filluar	Komuna+Komuniteti +Biznesi
23	Mbulimi me sistem të kanalizimit i tërë territorit të qytetit	400.000	Komuna 75%, Komuniteti 25%	Komuna+ Komuniteti	2 vite	Ka filluar	Komuna+Komuniteti +Biznesi
24	Asfaltimi i rrugëve të qytetit	320.000	Komuna 70%, Komuniteti 30%	Komuna+ Komuniteti	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuna+Komuniteti +Biznesi
25	Asfaltimi i rrugëve lokale	320.000	Komuna 70%, Komuniteti 30%	Komuna+ Komuniteti	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuna+Komuniteti +Biznesi
26	Asfaltimi i rrugëve në venbanimet rurale	140.000	Komuna 80%, Komuniteti 20%	Komuna+ Komuniteti	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuna+Komuniteti
27	Ndërtimi i deponisë së mbeturinave	730.000	Komuna 50%, Donatorët 50%	Komuna + Donatorët	1 vit	2005	Komuna+ Komuniteti
28	Zona industriale	150.000	Komuna 20%, Kom. i biznesit 80%	Komuna+ Kom. i Biznesit	1 vit	2006	Komuna+Biznesi+ OJQ
29	Mbështetja e bizneseve prodhuese	100.000	Komuna 80%, Kom. i biznesit 20%	Komuna+ Kom. i Biznesit	2 vite	Ka filluar	Komuna+Komuniteti +Biznesi
30	Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike	180.000	Komuna 80%, Donatorët 20%	Komuna+ Donatorët	I vazhdueshëm	Ka filluar	Komuniteti + Komuniteti+ Biznesi

31	Rregullimi i rrugëve për sipërfaqet bujqësore	50.000	Komuna 70%, Donatorët 30%	Komuna+ Donatorët	1 vazhdueshëm	2005	Fermerët+Komuniteti
32	Ndërtimi i sistemit të ujësjes në gjashtë fshatra	670.000	Komuna	Komuna	2 vite	Ka filluar	Komuna+Komuniteti+ Biznesi
33	Hulumtimi i resurseve natyrore (ujit)	90.000	Komuna 80%, Donatorët 20%	Komuna+ Donatorët	2 vite	Ka filluar	Komuna+Komuniteti +Biznesi
	Total	5,632,000					

PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE

<p align="center"><u>Projekti 1:</u></p> <p align="center"><u>Plani Gjeneral Urbanistik</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programeve:</u></p> <p align="center"><u>Programi i hartimit (planifikimit, disenjimit) të planit hapësinor urbanistik</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Qyteti i Ferizajt disponon me Planin Gjeneral Urbanistik të hartuar në vitin 1987-89, me afat të vlefshmërisë deri në vitin 2000, plan ky i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vitin 1992. Ky plan përfshin një sipërfaqe prej 650 ha. Në përgjithësi dokumentacioni teknik urban (plani urbanistik) për qytetin është i tejkaluar jo vetëm në kohë, por dhe si koncept i planifikimit paraqet një zgjidhje anakronike për nevojat e qytetit dhe si i tillë është i pazbatueshëm. Hartimi i Planit Gjeneral Urbanistik bëhet me qëllim të përcaktimit të caqeve afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor, si dhe promovimit të zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinor, harmonizimit të drejtpeshimit ndërmjet zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura, mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të regjimit të planifikimit urban në përputhje me standardet ndërkombëtare.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Shfrytëzimi i planifikuar i hapësirës së qytetit - Përmirësimi i rrethinës afariste për zhvillimin e bizneseve - Krijimi i kornizës ligjore për përdorimin e tokës si dhe standardet për mbrojtjen e ambientit jetësor 	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Bashkim Jashari, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, tel: +377 44 219 220</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti - Biznesi - OJQ-të profesionale
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Donatorët - OJQ-të lokale dhe shoqëria civile 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vetëdija e ngritur e të gjithë qytetarëve për domosdoshmërinë e planifikimit dhe të shfrytëzimit racional të hapësirës fizike - Janë paraparë burimet për financimin e projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vazhdimi në kontinuitet i shfrytëzimit pa plan të hapësirës fizike - Mungesa e ekspertëve profesionalë për realizimin e projektit - Shtyrja eventuale e mëtutjeshme e hartimit dhe aprovimit të planit urbanistik
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>350.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 2:</u></p> <p align="center"><u>Trajnimi i stafit për planifikim urban</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Programi për aprovimin e rregullativës për disenjimin e planit hapësinor</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Me qëllim të pjesëmarrjes në procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal; Planit Zhvillimor Urban; planeve rregulluese urbane dhe dokumenteve të tjera, si dhe në procesin e zbatimit të këtyre planeve, Kuvendi i Komunës së Ferizajt do të formojë dhe trajnojë ekipin komunal të planifikimit urban. Ky ekip komunal do të marrë pjesë në të gjitha fazat e hartimit dhe të implementimit të të gjitha planeve urbane të nivelit të komunës.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Evitimi i ndërtimeve pa leje - Kontrolli ndaj zgjerimit të zonave urbane - Themelimi i një zone industriale për inkubatorët e biznesit - Përmirësimi i rrethinës biznesore 	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Bashkim Jashari, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, tel: +377 44 219 220</p>	<p><u>Përfituesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti - Biznesi
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Donatorët - HABITAT- i 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Gatishmëria e qeverisë lokale - Ekspertët e Drejtorisë për Urbanizëm kanë filluar trajnimet 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e mjeteve financiare - Kapacitetet e pamjaftueshme në planifikimin urban
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>10.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 3:</u></p> <p align="center"><u>Themelimi i Zyrës për shërbime të shpejta dhe Zyrës për përkrahjen e bizneseve</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Programi i ndërlidhjes ndërmjet QL dhe bizneseve</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Kjo zyrë do t'i mundësonte komunitetit të biznesit që të sigurojë informacione dhe këshilla për asistencë të caktuar administrative. Zyra për shërbime të shpejta do të siguronte informacione relevante për bizneset si: regjistrimi, lëshimi i lejeve të punës, njoftimi mbi procedurat dhe shpenzimet për këtë qëllim, pastaj për ndryshimet eventuale në procedurat legjislative dhe administrative. Kjo zyrë do të zhvillonte edhe aktivitete të tjera. Do të zgjeronte partneritetin me komunitetin e biznesit, duke siguruar edhe informata për investitorët potencialë, strategjinë e biznesit privat, strukturën e bizneseve etj.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkrahja e bizneseve të reja - Përkrahja për zhvillimin ekonomik lokal - Rritja e të hyrave nga tatimet, taksat për pushtetin lokal - Përmirësimi i rrethinës afariste si për investitorë të brendshëm ashtu edhe për të huaj - Rritja e besueshmërisë ndaj pushtetit lokal 	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Biznesi
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti i biznesit - Shoqatat afariste dhe shoqata e ekonomistëve 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zotimi i institucioneve për përkrahje të bizneseve - Ekziston lokacioni në dispozicion 	<p><u>Faktorët e rrezikut:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mosbesimi i ndërmarrësve ndaj zyrtarëve - Mungesa e partneritetit dhe transparencës
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <p>20.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 4:</u></p> <p align="center"><u>Zona industriale</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Programi për nxitjen e bizneseve të reja prodhuese</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Qeveria lokale do të shpallë një apo disa lokacione si zona industriale. Komuniteti i biznesit dhe OJQ-të profesionale do të grumbullojnë mjetet monetare dhe do të shpallin tenderin publik për projektin urbanistik. Pasi të kalkulohen të gjitha paramasat dhe parallogaritë, do të shpallej tenderi për lejimin e shfrytëzimit të pronës, ku me marrëveshje do të përfshiheshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura e veprimtarive biznesore, shkalla e punësimit, tregjet e blerjes -shitjes - Ruajtja e ambientit - Çmimi i infrastrukturës, çmimi i projektit, çmimi i tokës në shfrytëzim 	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Tërheqja e investitorëve potencialë - Orientimi i mjeteve monetare në teknologji të avancuar - Shkarkimi i qytetit nga ngarkesa në komunikacion - Rritja e punësimit 	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Gafurr Ilazi, drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim, tel: +377 44 219 194</p>	<p><u>Përfituesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Biznesi - OJQ-të - Ministria për Tregti dhe Industri
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti i biznesit - OJQ-të profesionale 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja paraprake - Gatishmëria e palëve implementuese 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Korrupsioni - Interesat qiradhënëse
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <p>150.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 5:</u></p> <p align="center"><u>Themelimi i fondit të ZHEL-it</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Inkurajimi i bizneseve prodhuese</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Pushteti lokal, komuniteti i biznesit dhe OJQ-të do të krijojnë një fond për përkrahjen e bizneseve të reja, respektivisht të rinjve që kanë projekte konkrete për biznese të reja. Fondi do të krijohet në vazhdimësi nga këto burime: taksat komunale që i paguan komuniteti i biznesit, nga të hyrat të cilat arkëton komuna përmes sistemit fiskal. Ekipi i ekspertëve do të analizojë projektet dhe do të vendosë cili prej tyre është më i arsyeshëm për implementim.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Jetësimi i ideve për realizimin e bizneseve nga të rinjtë - Krijimi i ambientit të shëndoshë për NVM-të në komunë - Rritja e punësimit - Participimi në realizimin e projekteve 	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti - Biznesi
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Donatorët 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Serioziteti i palëve implementuese - Përgatitja paraprake selektive 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Injorimi i ideve të reja (frika nga e reja).
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <p>180.000 €</p>	

<p><u>Projekti 6:</u></p> <p><u>Krijimi i uebsajtit lokal</u></p>	<p><u>Lista e programeve që i përgjigjen projektit:</u></p> <p><u>Programi i ndërlidhjes ndërmjet QL dhe bizneseve</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Efektet nga krijimi i uebsajtit do të ishin shumëdimensionale. Do të rritej transparencja ndërmjet administratës lokale, biznesit dhe komuniteteve. Shfrytëzuesit do të mund shfletojnë uebsajtin për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme dhe njëkohësisht do t'u munësonte sektorit publik, biznesit privat dhe shoqërisë civile të komunikojnë në mënyrë më cilësore dhe më të shpejtë me partnerët. Përveç të tjerash, në uebsajt do të mund të shpallëshin tenderët publikë, bizneset do të informoheshin për rregulloret, dispozitat dhe aktet tjera të aprovuara nga Kuvendi Komunal, të cilat ndikojnë në veprimtarinë e tyre. Gjithsesi, krijimi i uebsajtit lokal do të ishte vektor i fuqishëm komunikimi ndërmjet qeverisë lokale dhe bizneseve, komunitetit dhe shoqërisë civile.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <p>Rriten shanset për investime Rritet mundësia e zhvillimit të sektorit privat Transparencë me madhe ndërmjet qeverisë lokale dhe sektorit privat Qasje më e mirë ndaj informatave lidhur me aspektet ligjore dhe administrative</p>	
<p><u>Udhëheqësi i projektit</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <p>Komuna Biznesi Diaspora Qytetarët tjerë të Kosovës</p>
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <p>Komuna Komuniteti i biznesit Organizatrat ndërkombëtare Organizatrat qeveritare dhe joqeveritare</p>	
<p><u>Parakushtet</u></p> <p>Ekziston infrastruktura adekuate (linja e internetit) Ekziston vullneti dhe dëshira e QL për krijimin e uebsajtit Ekziston zyra për teknologji informative</p>	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <p>Shërbimi i internetit ende nuk është funksional Mungesa e personelit të specializuar Mirëmbajtja e uebsajtit</p>
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Shpenzimet e kalkuluara për: trajnimin e personelit, për vënien në funksion të uebfaqes, për disenjimin dhe realizimin e faqes, për regjistrimin e faqes janë: 20.000 €</p>	

<u>Projekti 7:</u> <u>Trajnimi i stafit në teknologji informative dhe në lëmi të tjera</u>	<u>Lloji i programit:</u> <u>Programi i trajnimit të stafit komunal</u>
<u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u> Realizimi i këtij projekti nënkupton trajnimin e stafit në aplikacionet të cilat janë të domosdoshme për kryerjen efikase të punëve si: windows, word, excel, acces, intranet, internet etj. Blerja apo hartimi i programit për krijimin e bazës së të dhënave për NVM-të do të ofronte shërbime më të shpejta dhe më profesionale. Në disa drejtori stafi duhet të trajnohet edhe me programe të ndryshme teknike. Trajnimi profesional përfshin identifikimin paraprak të nevojave për trajnime. Duke pasur parasysh trendet në informatikë, trajnimi i stafit është një proces i cili duhet të vazhdojë në kontinuitet.	
<u>Rezultatet e pritshme</u> <ul style="list-style-type: none"> - Krijon bazë të të dhënave për qeverinë lokale - Krijimi i një partneriteti më të mirë ndërmjet pushtetit dhe sektorit privat - Rritja e kontributit të sektorit privat në buxhetin komunal 	
<u>Udhëheqësi i projektit</u> Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144	<u>Përfituesit</u> <ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti - Biznesi
<u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti i biznesit 	
<u>Parakushtet</u> <ul style="list-style-type: none"> - Disponueshmëria e organeve komunale - Përcaktimi i stafit për trajnim 	<u>Faktorët e rrezikut</u> <ul style="list-style-type: none"> - Largimi i personelit pas trajnimit
<u>Shpenzimet e llogaritura</u> 20.000 €	

<p align="center"><u>Projekti 8-9:</u></p> <p align="center"><u>Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e projekteve dhe për menaxhimin e buxhetit</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Programi i trajnimit të stafit komunal</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Kalimi nga një sistem ekonomik në tjetrin - në ekonominë e tregut - ka shkaktuar vështirësi te njerëzit dhe te komuniteti i biznesit, sepse përshtatja në ndryshime kërkon kohë. Trajnimi profesional përfshin identifikimin paraprak të nevojave për trajnime. Implementimi i tyre do të rezultojë në bashkëpunim me institucionet arsimore, shoqatat afariste, shoqatën e ekonomistëve, shoqatën e juristëve, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Ideja e projektit është që të organizojë trajnime, posaçërisht të asaj pjese të personelit që ka kontakte me klientët e biznesit. Këto trajnime duhet të zhvillohen që nga gjërat më të thjeshta, duke filluar nga pritja e klientëve, komunikimi me ta, përmirësimi i etikës dhe sjelljes së vet personelit e deri te gjërat më të sofistikuara sa i përket menaxhimit të zyrës, shërbimet e shpejta dhe efikase, përpunimit dhe azhurimi i bazës së të dhënave, aplikimi i metodologjive më të reja etj. Pas realizimit të trajnimeve vlerësojmë se do të ketë menaxhment më efikas në menaxhim të projekteve dhe të buxhetit.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e shërbimeve efikase të administratës komunale - Rritja e nivelit të profesionalizmit në ofrimin e shërbimeve - Rritja e nivelit të komunikimit 	
<p><u>Udhëheqësi i projektit</u></p> <p>Gafurr Ilazi, drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim, tel: +377 44 219 194</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti - Biznesi
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston mundësia në sigurimin e mjeteve për financimin e projekteve - Ekziston gatishmëria dhe kërkesa e stafit komunal që të trajnohet - Ekzistojnë pajisjet adekuate për trajnime 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi, nuk ka pengesa specifike, përveç mungesës së ekspertëve nga kjo fushë në nivelin lokal
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Trajnimi i stafit për menaxhimin e projekteve: 10.000 € Trajnimi i stafit për menaxhimin e buxhetit: 8.000 €</p>	

<u>Projekti 10:</u> <u>Aftësimi i asociacioneve të biznesit</u>	<u>Lloji i programit:</u> <u>Programi i ndërlidhjes ndërmjet QL dhe bizneseve</u>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Në komunën e Ferizajt aktivitetin e tyre e zhvillojnë edhe disa asociacione si: Shoqata e Biznesit, Shoqata e Ekonomistëve, Shoqata e Kontabilistëve, Shoqata e Juristëve, Shoqata e Fermerëve etj. Duke patur parasysh ndryshimet pozitive që ka sjellur ekonomia e tregut, këto asociacione vazhdimisht duhet aftësuar, sepse përmes tyre do të lehtësohej dhe do të avancohej rrethina biznesore. Përmes njohjes me ligjet e reja, aplikimit të teknologjisë informatike, trajnimeve nga ekspertët e lëmive përkatëse, aplikimit të metodologjisë së punës në vendet e zhvilluara dhe ato në tranzicion, asociacionet do të aftësoheshin që bizneset në komunë të përfillin konceptet e menaxhmentit modern.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <p>Përmirësimi i rrethinës afariste Përmirësimi i strukturës së bizneseve Informacionet për ekonominë lokale sigurohen më lehtë</p>	
<p><u>Udhëheqësi i projektit</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <p>- Komuna - Biznesi</p>
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <p>- Komuna - Komuniteti i biznesit</p>	
<p><u>Parakushtet</u></p> <p>Aktiviteti në kontinuitet i asociacioneve Gatishmëria e qeverisë lokale Gatishmëria e komunitetit të biznesit</p>	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <p>- Buxheti jo i mjaftueshëm</p>
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>10.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 11:</u></p> <p align="center"><u>Mbështetja e bizneseve prodhuese</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Programi për nxitjen e bizneseve të reja prodhuese</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Ideja e qeverisë lokale që të stimulojë bizneset, në veçanti ato prodhuese, është e kahershme. Kohë më parë Asambleja Komunale ka liruar nga taksa komunale dhe ka shpallur dy zona industriale për biznese prodhuese. Sipas shënimeve të deritanishme, vetëm 16 % e bizneseve të regjistruara janë prodhuese dhe deri në fund të vitit 2007 pretendohet që kjo strukturë të përmirësohet dhe më shumë se ¼ e bizneseve të jenë prodhuese. Përmes këshillimeve, lehtësimeve administrative, promovimit të prodhimeve vendore dhe formave të tjera do të insistohet që bizneset prodhuese të kenë epitetin e të "privilegjuarave".</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <p>Përmirësimi i strukturës së bizneseve Hapja e vendeve të reja të punës Rritja e investimeve</p>	
<p><u>Udhëheqësi i projektit</u></p> <p>Gafurr Ilazi, drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim, tel: +377 44 219 194</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti - Biznesi
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti i biznesit - Donatorët 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <p>Disponueshmëria e qeverisë lokale Oferta joshëse për bizneset prodhuese Gatishmëria e komunitetit të biznesit</p>	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <p>Konkurrenca jolojale në treg Tarifat e larta në importimin e lëndës së parë</p>
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>100.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 12:</u></p> <p align="center"><u>Anketimi i komunitetit të biznesit</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Programi i ndërlidhjes ndërmjet QL dhe bizneseve</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Anketimi me komunitetin e biznesit parasheh anketim të bizneseve nga një spektër i gjerë sektorësh, me qëllim që të fitohen sa më shumë informata mbi nevojat ekzistuese, qëllimet, pengesat dhe çështje të tjera, të cilat "shqetësojnë" bizneset. Kjo anketë do të realizohet përmes një pyetësori të cilin do ta përgatisë Drejtoria për Ekonomi dhe Financa. Rezultatet e anketimit do të tregojnë për sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset në mënyrë që më pas të disenjohen projekte për tejkalimin e tyre. Prioritet në këtë anketim do të kenë bizneset prodhuese. Ky projekt do të realizohet në bashkëpunim me shoqatat afariste.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxiti zhvillimin e afarizmit privat - Rrit transparencën ndërmjet qeverisë lokale dhe komunitetit të biznesit - Ofron pasqyrë mbi prodhimet dhe shërbimet e bizneseve 	
<p><u>Udhëheqësi i projektit :</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Biznesi
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti i biznesit 	
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Disponueshmëria e qeverise lokale - Gatishmëria e komunitetit të biznesit për t'u inkuadruar në implementimin e projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Buxheti jo i mjaftueshëm
<p><u>Shpenzimet e llogaritura :</u></p> <p>3.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 13:</u></p> <p align="center"><u>Buletini informativ i biznesit</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Programi i ndërlidhjes ndërmjet QL dhe bizneseve</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Buletini informativ i biznesit do të ishte promovues i ofertës dhe i kërkesës së produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë bizneset në komunën e Ferizajt. Këtu do të prezantoheshin të gjitha informacionet mbi llojin e prodhimeve /shërbimeve, cilësinë e tyre, çmimet, selinë e kompanisë, adresën. Ky buletin do të përkthehej edhe në gjuhën angleze për përdoruesit e jashtëm. Rifreskimi i tij me të dhëna më të reja do të bëhej çdo muaj ose çdo tre muaj. Një buletin i tillë i ka munguar komunës sonë.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme:</u></p> <p>Rrit mundësinë për zhvillimin e sektorit privat Siguron informacione për ekonominë lokale Promovon bizneset lokale në tregun mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar</p>	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <p>Komuna Bizneset lokale Diaspora, kompanitë vendore dhe të jashtme</p>
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <p>Komuna Komuniteti i biznesit OJQ-të Organizatat ndërkombëtare</p>	
<p><u>Parakushtet</u></p> <p>Interesimi i bizneseve për të paguar për promovimin e veprimtarisë së tyre Oferta e caktuar e mallrave dhe shërbimeve nga bizneset lokale</p>	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <p>Pamundësia e kooperimit dhe e arritjes së marrëveshjes për financimin e projektit Disa biznese nuk do të tregojnë gatishmëri për të participuar</p>
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Shpenzimet për grumbullimin dhe sistemimin e informacioneve: 3.000 € Shpenzimet për disenjim dhe përgatitje teknike për botim: 5.000 € Një pjesë e shpenzimeve mund të mbulohen nga bizneset lokale në proporcion me hapësirën e shfrytëzuar për veprimtarinë e tyre në buletin informativ të biznesit</p>	

<p align="center"><u>Projekti 14:</u></p> <p align="center"><u>Binjakëzimi i komunave</u></p>	<p align="center"><u>Lista e programeve që i përgjigjen projektit:</u></p> <p align="center"><u>Programi për promovimin e investimeve</u></p>										
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Komuna e Ferizajt ka filluar bashkëpunimin me disa komuna të vendeve të tjera. Motivi i këtij projekti është që të ndërmerren aranzhmane të binjakëzimit për shkëmbimin e përvojave pozitive. Përveç pushtetit lokal, në këtë drejtim kontributin e tyre mund ta japin edhe shoqatat afariste, mërgimtarët nga diaspora. Pas vendosjes së rregullave themelore të partneritetit, komunikimi ndërmjet komunave do të jetë më i lehtë dhe më efikas. Janë shumë segmente në të cilat mund të bashkëpunohet me komunat tjera si: investimet e përbashkëta, reciprociteti në shitjen e produkteve, organizimi i panairëve, shkëmbimi i përvojave në qeverisjen komunale, promovimet e ndryshme etj.</p>											
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e chansave për NVM-të lokale që të gjejnë partnerë dhe tregje në komunat tjera - Tërheqja e kapitalit dhe e investimeve të jashtme - Përvojat në fusha të ndryshme 											
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti - Biznesi - Diaspora 										
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <p>Komuna Shoqatat afariste Diaspora</p>											
<p><u>Parakushtet</u></p> <p>Gatishmëria e pushtetit lokal për ta mbështetur projektin Interesimi i diasporës për promovimin e komunës së Ferizajt</p>	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <p>Mungesa e përvojës në programe të tilla Frika nga shfrytëzimi i këtyre programeve për nevoja personale</p>										
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <table border="0"> <tr> <td>Materiali promovues:</td> <td align="right">3.000 €</td> </tr> <tr> <td>Vizita partnerëve:</td> <td align="right">8.000 €</td> </tr> <tr> <td>Marrëdhëniet me publikun:</td> <td align="right">5.000 €</td> </tr> <tr> <td>Shpenzime administrative:</td> <td align="right">4.000 €</td> </tr> <tr> <td>Total :</td> <td align="right">30.000 €</td> </tr> </table>		Materiali promovues:	3.000 €	Vizita partnerëve:	8.000 €	Marrëdhëniet me publikun:	5.000 €	Shpenzime administrative:	4.000 €	Total :	30.000 €
Materiali promovues:	3.000 €										
Vizita partnerëve:	8.000 €										
Marrëdhëniet me publikun:	5.000 €										
Shpenzime administrative:	4.000 €										
Total :	30.000 €										

<p align="center"><u>Projekti 15:</u></p> <p align="center"><u>Formimi i klubit të ambasadorëve</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Inkurajimi i investimeve</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Ideja e qeverisë lokale është që të formojë Klubin e Ambasadorëve, me qëllim të mbajtjes së takimeve të rregullta me bashkatdhetarët tanë në të gjitha vendet ku ata jetojnë. Atyre do t'ju ofroheshin informacione relevante për mundësinë e investimeve në Ferizaj, por edhe në qytetet tjera në Kosovë. Me bashkatdhetarët do të shkëmbeheshin edhe përvojat pozitive nga sektorët e ndryshëm të biznesit.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <p>Investime të reja Inkurajimi i biznesit privat Promovimi i bizneseve të suksesshme Shkëmbimi i përvojave</p>	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Dukagjin Etemi, udhëheqës i Ekipit të ZHEL-it Tel: +377 44 121 144</p>	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Biznesi - Komuniteti - Diaspora
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <p>Komuna Donatorët Komuniteti i biznesit Diaspora</p>	
<p><u>Parakushtet</u></p> <p>Zotimi i institucioneve Ekziston udhëheqësi i projektit</p>	<p><u>Faktorët e rrezikut:</u></p> <p>Mosinteresimi i diasporës Pasiguria në investime Konkurrenca jo e mirëfilltë</p>
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <p>25.000 €</p>	

<u>Projekti 16:</u> <u>Krijimi i inkubatorit të biznesit</u>	<u>Lloji i programit:</u> <u>Inkurajimi i investimeve</u>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Në qytetin e Ferizajt ekzistojnë hapësira punuese të pashfrytëzuara, të cilat mund të shndërrohen në inkubator të biznesit, i cili do të shërbente si lokacion për biznese të reja dhe ato ekzistuese, të cilat në një perspektivë mund të zgjerohen. Inkubatori i biznesit mund të jetë edhe mjet për promovimin e bizneseve specifike, ose mund të shërbejë edhe si mjet për inkurajimin e grupeve specifike më pak të avancuara. Ky projekt mund të monitorohet nga një qendër për këshilla, nga Zyra për shërbime të shpejta apo nga ndonjë institucion profesional afarist. Shpenzimet për ndërmarrësit do të jenë më të vogla si në: asistencë, energji, telefon, ujë, kanalizim, menaxhim për mirëmbajtjen e librave, rrjet kompjuterik etj.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme:</u></p> <p>Hapja e vendeve të reja të punës Rritja e numrit të bizneseve Përmirësimi i rrethinës biznesore Promovimi i veprimtarive në fusha të ndryshme</p>	
<p><u>Udhëheqësi i projektit :</u></p> <p>Gafurr Ilazi, drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim, tel: +377 44 219 194</p>	<p><u>Përfituesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Bizneset me veprimtari specifike - Bizneset fillestare - Grupet më pak të avancuara (të papunët, femrat, të rinjtë)
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit</u></p> <p>Komuna Komuniteti i biznesit Institucionet financiare Diaspora</p>	
<p><u>Parakushtet</u></p> <p>Objektet ekzistuese Ekzistojnë ekspertët për ofrimin e shërbimeve</p>	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kushtet e pavolitshme të kreditimit
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për renovimin e objekteve, pajisje, për paga etj. nevojiten 350.000 €</p>	

<p align="center"><u>Projekti 17:</u></p> <p align="center"><u>Pjesëmarrja në projekte të donatorëve</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Inkurajimi i investimeve</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Në realizimin e disa projekteve nga donatorët (organizatat ndërkombëtare, ministritë) kërkohet që të participojë edhe komuna, me një pjesëmarrje të caktuar. Për këtë arsye komuna, gjatë hartimit të buxhetit, ka paraparë që të ndajë mjete, në mënyrë që të mos ketë pengesa në tërheqjen e investimeve. Ndarja e këtyre mjeteve është garancë se komuna është e gatshme të stimulojë investimet dhe të jetë e përgatitur për ofertat eventuale për bashkëpunim - realizim të projekteve me donatorë.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <p>Tërheqja e investime të reja Përmirësimi i infrastrukturës Përmirësimi i ambientit për investime</p>	
<p><u>Udhëheqësi i projektit:</u></p> <p>Gafurr Ilazi, drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim, tel: +377 44 219 194</p>	<p><u>Përfituesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti - Biznesi - OJQ-të
<p><u>Partnerët potencialë për implementimin e projektit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuna - Komuniteti i biznesit - Donatorët 	
